



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës- Drejtoria e Arsimit  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



---

## Dokument informues për vëzhguesit e Komisioneve përzgjedhëse për rekrutimin e pozitave udhëheqëse të institucioneve edukativo-arsimore

Të nderuar vëzhgues/e të Komisionit,

Ju faleminderit për kontributin tuaj që procesi i përzgjedhjes së drejtorëve apo zv. drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore në Komunën tuaj të jetë sa më transparent dhe meritore.

Ky Dokument Informues i liston hapat kryesor që duhet të ndodhin gjatë këtij procesi. Ky Dokument duhet të lexohet së bashku me Konkursin përkatës, duke përfshirë dokumentet relevante që e shoqërojnë atë.

### ANËTARËT QË MUND TË MARRIN PJESË SI VËZHGUËS TË PROCESIT SË PËRZGJEDHJES

Vëzhgues mund të jenë:

1. Përfaqësues të Këshillit të Prindërve të Prishtinës, të cilët kane aplikuar në Thirrjen Publike për Ekspert të Pavarur, të publikuar nga Komuna e Prishtinës me 4 maj 2022;
2. Përfaqësues të Këshillit Drejtues të Shkollës për të cilën është i hapur Konkursi, një prind dhe një mësimdhënës;
3. Përfaqësues të Komisionit Parlamentar për Arsim;
4. Asambleistë të Kuvendit Komunal të Prishtinës, anëtarë të Komitetit për Arsim;
5. Partnerë dhe donatorë që kanë marrëveshje aktive me DKA-në e Komunës së Prishtinës;
6. Vëzhgues të nominuar nga Ambasada Britanike, të cilët janë duke i mbështetur proceset transparente dhe meritore të përzgjedhjes së kandidatëve në poste publike.

## PROCESI I PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE DHE OBLIGIMET E PALËVE TË INVOLVUARA

### HAPI 1: SHQYRTIMI I DOKUMENTACIONIT TË KANDIDATËVE

#### **Obligimet e DKA-së**

- T'ju ofrojë kopje të dokumentacionit të secilit kandidat për pozitën e hapura.
- Ta promovojë maksimalisht Konkursin, përmes kanaleve të komunikimit të Komunës dhe medieve.
- Ta organizojë takimin e Komisionit, ku bëhet kontrollimi i dokumentacionit të kandidatëve, sipas Formularit B, dhe konfirmohet lista e ngushtë e kandidateve për intervistim.
- Detyra dhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

#### **Obligimet e Komisionit**

- Ta bëjë kontrollimin e dokumentacionit të kandidatëve, sipas Formularit B, dhe konfirmohet lista e ngushtë e kandidateve për intervistim.
- Detyra dhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

#### **Obligimet e anëtarit vëzhgues**

- Ta vëzhgoni procesin e kontrollimit të dokumentacionit nga Komisioni.

### HAPI 2: INTERVISTIMI I KANDIDATËVE

#### **Obligimet e DKA-së**

- Ta organizojë intervistimin e të gjithë kandidatëve që i kanë plotësuar kushtet sipas Formularit B.
- Të sigurohet se të gjithë kandidatët për intervistë dhe institucioni edukativo-arsimor janë të informuar për datën dhe orën e intervistës, sipas nenit 8 të UA 151/2020.
- Detyra dhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

#### **Obligimet e Komisionit**

- T'i intervistojë, në mënyrë të barabartë, të gjithë kandidatët që i kanë plotësuar kushtet sipas Formularit B.
- Të bëjnë vlerësimin e kandidatëve në mënyrë të pavarur, në prezencën e vëzhguesve të Komisionit, të realizojnë mbledhjen e pikëve nga Formulari C për secilin kandidat dhe t'i bartin këto në Formularin D. Ky proces duhet të ndodhë brenda ditës së intervistimit.
  - a. Nëse, për shkak të numrit të madh të kandidatëve për të njëjtën pozitë, nuk është e mundur që të bëhet vlerësimi përfundimtar i të gjithë kandidatëve dhe

përpilimi i rekomandimit sipas Formularit D, atëherë plotësimi i këtij Formulari duhet të realizohet në ditën kur përfundojnë të gjitha intervistat për pozitën përkatëse.

- Detyra dhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

### **Obligimet e anëtarit vëzhgues**

- Ta vëzhgoni procesin e kontrollimit të dokumentacionit nga Komisioni.
- Të plotësohet dhe nënshkruhet Formularit F, sipas Udhëzimi administrativ (MASH) NR.151/2020.Linku:  
<https://masht.rks-gov.net/shtojca-e-ua-151-1-formularet-per-vlersimin-e-kandidatve-per-dr-ejtor-dhe-zevendesdrejtor-te-iea/>
- Në asnjë moment anëtarët vëzhgues nuk kanë të drejtë të bëjnë xhirime apo të interferojnë në çfarëdo forme procesin e intervisimit të kandidatëve.